

VENDIM
Nr.924, datë 2.9.2009

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1672, DATË 24.12.2008, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN DHE PUBLIKIMIN ZYRTAR TË
NOMENKLATURËS SË KOMBINUAR TË MALLRAVE, 2009”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 2 të ligjit nr.9461, datë 21.12.2005 “Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kapitullin 84 të seksionit XVI të tekstit të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2009, që i bashkëlidhet vendimit nr.1672, datë 24.12.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Përshkrimi i kodit tarifar të sistemit të harmonizuar 8418 30 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8418 30 “Ngrirës të tipit pingul (me hapje nga lart), që nuk e kalojnë një kapacitet prej 800 l”;

2. Përshkrimi i kodit tarifar të sistemit të harmonizuar 8418 40 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8418 40 “Ngrirës të tipit dollap (me hapje ballore), që nuk e kalojnë një kapacitet prej 900 l”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha